



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 3391

NR. VENDIMI 2943



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

NR. 2242 S.P./3391 AKTI

NR. 2943 VENDIMI

Dt. rregj. 11.08.2021 SP/ 21.10.2021 regj.them.

Dt.

05.11.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtar: SOKOL PASHO

asistuar nga sekretare gjyqesore Etleva Avdia, me pjesëmarrjen e prokurorit Gjergji Tako sot me date 05.11.2021, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

I PANDEHUR:

Illir Doraci, i biri i Mynyr dhe Bejlere, i dtl. 10.10.1971, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, Rr. “Hamdi Pepa”, Lagjia 6, Kombinat, Konvikti i Ndërtimit, me shtetësi shqiptare, me arsim të mesëm, i dënuar më parë, i përfaqësuar me autorizim nga av. Aldor Hysenlikaj, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. 8850 liçense.

AKUZUAR:

Për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, të parashikuar nga neni 283/1 dhe 285/a i K.Penal.

2. Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhim dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni

283/1 i Kodit Penal për:

Personin nën hetim:

Ortenc Nazja, i biri i Syrja dhe Silvana, i dtl. 14.11.1998, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. “Grigor Hebo”, pall.45/1, arsim i mesem, me shtetesi shqiptare, i padenuar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. J51114049F, në mungesë.

3. Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal për:

Personat nën hetim:

1. Eugen Lazri, i biri i Xhevat dhe Anila, i dtl. 21.12.1989, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Alla, me shtetesi shqiptare, beqar, në mungesë.

2. Erjon Pere, i biri i Bardhyl dhe i Zamira, i dtl. 18.09.1993, lindur dhe banues ne Tirane, Rr. Bilal Golemi, me shtetesi shqiptare, beqar, me arsim 9 vjecar, në mungesë.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet e palëve, mori e administroi provat e nevojshme, dëgjoi përfundimisht palët që kërkuan:

Prokurori Gjergji Tako:

- Te shpallet fajtor i pandehuri Ilir Doraci për konsumim të veprës penale parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.
- Në bazë të nenit 283/1 të K.Penal të dënohet i pandehuri Ilir Doraci me 6 vjet burgim.
- Te shpallet fajtor i pandehuri Ilir Doraci për konsumim të veprës penale parashikuar nga neni 285/a i K.Penal.
- Në bazë të nenit 285/a të K.Penal të dënohet i pandehuri Ilir Doraci me 2 vjet burgim.
- Në baze të nenit 55 të K.Penal të dënohet me një dënim të vetëm prej 7 vjet e 6 muaj burgim dhe më pas të aplikohet neni 406 i K.Pr.Penale.
- Në bazë të neni 190 të K.Pr.Penale prova materiale lëndë narkotike të shkatërohet ndërsa sendet e tjera të sekuestruara t’ju kthehen pronarëve të ligjshëm.
- Shpenzimet gjyqësore në bazë të nenit 393/1 të K.Pr.Penale ti ngarkohen te pandehurit sipas procesverballi te dosjes në masën 24.500 lekë.

Mbrojtësin e të pandehurit Ilir Doraci, av. Aldor Hysenlikaj:

- Deklarimin fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal, caktimin e një masë sa më të butë dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal.
- Shpalljen e pafajshëm të të pandehurit per veprën penale të parashikuar nga neni 285/a K.Penal pasi nuk provohet se e ka kryer bazuar në nenin 388/d të K.Pr.Penale.

V Ë R E N:

Se Prokuroria i është drejtuar Gjykates me kërkesën nr. 2242 Akti, datë 11.08.2021 regjistrimi me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 8238 të vitit 2020, në ngarkim të të pandehurit Ilir Doraci, i akuzuar për veprat penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, të parashikuar nga neni 283/1 dhe 285/a i K.Penal; pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për personin nën hetim Ortenc Nazja; si dhe pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, për personin nën hetim Eugen Lazri dhe Erion Pere, duke i bashkëlidhur kërkeses edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli përkatës.

I pandehuri Ilir Doraci gjatë hetimeve paraprake nuk ka paraqitur kontestime, ndërsa në seancën paraprake, ai kerkoi gjykim të shkurtuar, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjëndjen që janë aktet në fashikullin e Prokurorisë të sjellë për gjykim, ndaj dhe Gjykata bazuar në nenet 405 dhe 406 të K.Pr.Penale, u shpreh dakord që të procedohet me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjëndjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenit 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga i pandehuri.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen konkluzionet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialit referues të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 8238, viti 2020, në ngarkim të shtetasve Ilir Doraci dhe Ortenc Nazja për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, si dhe në ngarkim të shtetasve Eugen Lazri dhe Erion Pere për veprën penale të parashikuar nga neni 301 i K.Penal.

Nga aktet e administruara rezulton se, në datën 19.11.2020 Seksioni i Luftës kundër lëndëve narkotike në Drejtorinë Vendore të Policisë së Shtetit mori informacion se në lokalitetin “WEST” në rrugën “Haxhi Kika” mbaheshin, tregtoheshin dhe konsumoheshin lëndë narkotike.

U krijua një grup pune dhe rreth orës 22.30, Policia Gjyqësore kreu ndërhyrje në këtë

lokal. Në hyrje të lokalit, afër derës kryesore u bllokua administratori i lokalit Ilir Doraci, i cili tentoi të futej me vrap në lokal, por është bllokuar menjëherë. Më pas punonjësit e policisë kanë hyrë brenda dhe kanë vërejtur një tavoline bilardo dhe disa tavolina. Kanë vijuar kontrollin në pjesën e banakut të lokalit ku u gjet shtetasi Ortenc NAZIA pas banakut. Është gjetur një qese me shënimin “Market Kaloshi” me lëndë të dyshuar Cannabis Sativa. Pas sekuestrimit dhe peshimit rezultoi në masën 366 gramë me gjithë ambalazh. Në pjesën pas banakut u gjet një qese me mbishkrimin “Pads” brenda të cilës kishte qese farmaceutike dhe letra alumini të bëra gati me lëndë të dyshuar Cannabis Sativa, ku pas sekuestrimit dhe peshimit rezultoi të ishin 12 doza në masën totale 20,8 gramë me gjithë ambalazh.

Ka vijuar kontrolli në një dhomë tjetër ku në ballkonin e kësaj dhome është gjetur shtetasi Rinaldo Braho në posedim të një cigare të dyshuar si Cannabis Sativa. Është vijuar kontrolli në një dhomë të dytë ku sapo punonjësit e policisë u futën dy shtetasit Eugen Lazri dhe Erion Pere filluan të hidhnin nga dritarja një lëndë të dyshuar si kokainë. Punonjësit e Policisë i kanë bllokuar dhe kanë sekuestruar një pluhur të bardhë të dyshuar si kokainë si në parvazin e dritares ashtu dhe në tavolinën që gjendej në dhomë.

Gjatë hetimeve janë pyetur shtetasit e arrestuar me përfundimet e mëposhtme: Shtetasi Ilir Doraci ka refuzuar që të flase duke shfrytëzuar këtë të drejtë të tij.

Shtetasi Ortenc Nazja ka shpjeguar se është i punësuar prej shtetasit Ilir Doraci dhe është në kohë prove. Ai ka shpjeguar se nuk ka lidhje me pjesën e lëndës narkotike që u gjend pas banakut. Ai shpjegon se nuk është përdorues i lëndëve narkotike përveç ndonjë rasti të hershëm sporadik.

Gjatë hetimeve është pyetur shtetasi Eugen Lazri i cili ka shpjeguar se kur shkoi me shokun e tij Erion Pere në këtë lokal për të luajtur playstation gjetën lëndën narkotike kokainë dhe vendosën ta konsumonin.

Gjithashtu është pyetur shtetasi Erion Pere i cili shpjegon se kur shkoi me shokun e tij Eugen Lazri në këtë lokal për të luajtur Playstation në tavolinën e dhomes ku ishte playstation gjetën lëndën narkotike kokainë dhe vendosën ta konsumonin.

Nga policia është pyetur shtetasi Rinaldo Braho i cili ka shpjeguar se kishte shkuar në lokalin “West” për të luajtur Playstation. Aparatin e playstation e gjeti të zënë dhe duke pritur që të lirohej doli në ballkon për të konsumuar një cigare hashash pasi është përdorues i lëndës narkotike.

Ka vijuar hetimi dhe është kryer ekspertimi daktiloskopik i një gjurme të gjetur në qesen me mbishkrimin “Pads”. Në bazë të aktit date 26.11.2020 është përcaktuar se tek qesja me mbishkrimin “Pads” u gjetën dy gjurmë daktiloskopike në lartësinë 7 cm dhe 3 cm nga fundi i qeses. Këto dy gjurmë janë të vlefshme për identifikim. Në vijim është kryer ekspertimi daktiloskopik krahasues me të dyshuarit e ngjarjes dhe në aktin daktiloskopik nr.1,446 date 09.02.2021 është përcaktuar se këto dy gjurmë janë të krijuara nga gisht i mesit i dorës së djathtë të shtetasit Ilir Doraci.

Duke u lidhur kjo provë shkencore me qëndrimet e të pandehurit Ilir Doraci dhe Ortenc Nazja, prokurori konkludon se para Gjykatës përcaktohet se shtetasi Ortenc Nazja nuk mund të mbajë përgjegjësi penale për nenin 283 të K.Penal pasi qëndrimi i Ilir Doraci e shkarkon nga përgjegjësia dhe nuk ka prova të tjera asnjëse të natyrës objektive që ta ngarkojë me përgjegjësi penale.

Gjatë hetimeve është administruar ekspertimi kimik nr. 1577, datë 12.02.2021 ku

përcaktohet se dy sasite me material bimor të sekuestruara pas banakut të lokalit janë Cannabis Sativa në masën 323 gramë pa ambalazh njëra dhe 12 gramë pa ambalazh tjetra. Duke u lidhur kjo provë shkencore me ekspertimin daktiloskopik dhe me qëndrimin e të pandehurit Ilir Doraci, sipas prokurorit para Gjykatës shtetasi Ilir Doraci duhet të mbajë përgjegjësi penale për konsumim të nenit 283/1 dhe 285/a të K.Penal.

Gjithashtu është administruar ekspertimi kimik nr. 1699 date 17.02.2021 ku është përcaktuar se pluhuri që iu kap shtetasve Eugen Lazri dhe Erion Pere është në sasinë 2.35 gramë dhe nuk përmban asnjë lloj lëndë psikotrope apo narkotike.

Këto rrethana u provuan me :

- Raport shërbimi, datë 22.02.2021.
- Procesverbal i kapjes në flagrancë, datë 19.11.2020.
- Procesverbal i kqyrjes së vendit të ngjarjes datë 19.11.2020.
- Procesverbal sekuestrimi date 20.11.2020
- Procesverbal i peshimit të lëndës datë 20.11.2020
- Procesverbal i marrjes së kampionit të urinës
- Procesverbal i arrestimit në flagrancë
- Akti ekspertimi kimik nr. 1699 date 17.02.2021
- Akti ekspertimit daktiloskopik 11,172 date 26.11.2020
- Akte të tjera procedurale të gjendura në fashikull.

Mbi bazën e këtyre fakteve nga akuza u kërkua deklarimi fajtor i të pandehurit Ilir Doraci, për kryerjen e veprave penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, të parashikuar nga neni 283/1 dhe 285/a i K.Penal dhe dënimi i tij, në masën e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke parashtruar se me veprimet e tij të kryera me dashje, i pandehuri ka konsumuar elementët e veprave penale të parashikuar nga neni 283/1 dhe 285/a të K.Penal, si dhe pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për personin nën hetim Ortenc Nazja; si dhe pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, për personin nën hetim Eugen Lazri dhe Erion Pere.

Nga ana e avokatit Aldor Hysenlikaj u parashtrua se lënda narkotike që është gjetur në brendësi të ambjentëve që administroheshin nga i pandehuri Ilir Doraci, ishte e tij dhe këtë sasi lënde narkotike e kishte për përdorim vetjak. Këtë sasi lënde narkotike ai e kishte blerë me cmim shumë të lirë dhe duke qënë në kushtet kur është përdorues prej vitesh kishte vendosur që ta blinte.

Gjithashtu nga ana e avokatit në lidhje me akuzën e ngritur nga ana e prokurorisë për sa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 285/a të Kodit Penal, “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, u sqarua se nuk ishin dakort dhe në lidhje me këtë akuzë kërkoi nga Gjykata

deklarimin e pafajshëm, pasi në rastin konkret nuk është provuar se ambjenti që administrohej nga i pandehuri, konsumohej lëndë narkotike.

Në lidhje me procedimin penal Nr. 8238 të viti 2020 në ngarkim të të pandehurit Ilir Doraci, nga ana e prokurorisë është pushuar procedimi penal ndaj personave nën hetim Eugen Lazri dhe Erjon Pere, pasi nga rrethanat e ndodhjes së ngjarjes ashtu sic shikohet në aktin për përfundimin e hetimeve, në lidhje me këto dy shtetas është ngritur dyshimi se në ambjentin e Play-Station ku administrohej nga i pandehuri Ilir Doraci, po mbanin dhe konsumonin lëndë narkotike të llojeve të ndryshme. Por pas administrimit të akteve të ekspertimit Kimik Nr. 1699, datë 17.02.2021 ka rezultuar se pluhuri që është konstatuar nuk është lëndë narkotike, në këto kushte arrihet në konkluzionin se këto shtetas nuk kanë konsumuar lëndë narkotike në ambjentin e të pandehurit Ilir Doraci. Sipas avokatit jemi përpara faktit se akuza në ngarkim të të pandehurit Ilir Doraci nuk mund të qëndroj dhe në këto kushte duhet të deklarohet i pafajshëm.

Në lidhje me akuzën e parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal, ai sqaroi se e pranojmë dhe ndihemi të penduar. Përsa i përket llojit dhe masës së dënimit, që duhet të vuajë i pandehuri çmojmë se, Gjykata, duhen të mbajë parasysh dispozitat e nenit 47, 48 dhe 49 të Kodit Penal.

Sipas avokatit gjykata ne caktimin e llojit dhe masës së dënimit duhet që të marrë parasysh faktin që i pandehuri Ilir Doraci, ndihet i penduar, akuzën e ngritur nga ana e Prokurorisë e pranon (pjesërisht), duke u shprehur mjaft i penduar për veprimin e kryer; faktin që i pandehuri është babai i një fëmije nga martesë e tij e parë dhe ka detyrimin për kontribut ushqimor; faktin se jeton vetëm me bashkëshorten e tij; faktin se pas kryerjes së veprës penale, i pandehuri ka shfaqur sjellje të mirë; mosha e të pandehurit; gjendja shëndetësore e familjarëve të tij (bashkëshortes) dhe nevoja e domosdoshme që pandehuri ka për tu përkujdesur për familjen e tij.

Nisur nga sa me sipër ai kërkoi nga Gjykata që ta dënojë të pandehurin Ilir Doraci në bazë të Nenit 283/1 të Kodit Penal përfundimisht me minimumim e dënimit duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal; shpalljen e pafajshme në lidhje me akuzën e “Përshtatje të ambjenteve për përdorim të lëndëve narkotike” të parashikuar nga Neni 285/a i Kodit Penal, pasi nuk provohet se i pandehuri Ilir Doraci e ka kryer veprën penale bazuar në nenin 388/d të Kodit të Procedurës Penale.

Arsyetimi i Gjykatës, argumentat juridike, interpretimi dispozitave penale, analiza e provave.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, përcaktimit të faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Ilir Doraci, plotësojnë të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar, për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, në formën e mbajtjes, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë.

Në përmbajtjen e nenit 283 të K.Penal, të miratuar me Ligjin Nr.7895, datë 27/01/1995, sanksionohet se:

“Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shperndarja, tregtimi,

transportimi, dergimi, dorezimi si dhe mbajtja, pervec rastit te perdorimit vetjak dhe ne doza te vogla, te substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farerave te bimeve narkotike, ne kundërshtim me ligjin, ose në kapercim të permbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pese gjer ne dhjete vjet.

-Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesembëdhjetë vjet.

-Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, denohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.”

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se ligjvënësi, ka parashikuar një mbrojtje të posaçme juridike të marrëdhënieve që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen, transportimin, dhe mbajtjen sipas dispozitave ligjore përkatëse, të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme.

Sipas kësaj dispozite, veprimet që çënojnë marrëdhëniet e sipërpërmendura passjellin përgjegjësi penale.

Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që:

-të kenë prekur marrëdhëniet juridike (dispozitat përkatëse ligjore) që rregullojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen apo përdorimin vetjak të lëndëve narkotike;

-**nga ana objektive** këto veprime duhet të jenë aktive, me anë të të cilave personi të kryejë shitje, blerje, **mbajtje**, transportim, tregëtim, shpërndarje, dorëzim të lëndëve narkotike, në mënyrë të kundraligjshme e shoqërisht të rrezikshme;

-**subjekti** që kryen këto veprime duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur 14 vjeç;

-Veprimet e autorit të veprës penale duhet të kryhet me dashje direkte.

Objekti i veprës penale, janë marrëdhëniet juridike të vendosura me Ligjin Nr.7975, datë 26/07/1995 “Për barnat narkotike dhe psikotrope”, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, rregjimin juridik për shitjen, dhënien, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri, me veprimet e kunderligjshme janë manifestuar në formën e mbajtjes së lëndës narkotike 323 gramë pa ambalazh njëra dhe 12 gramë pa ambalazh tjetra, e cila sipas aktit të ekspertimit kimik me nr. 1577, datë 12.02.2021 rezulton të jetë cannabis sativa.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri me faj në formën e dashjes direkte, pasi i pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimeve të tij dhe pasojat e veprës.

Subjekt i kryerjes së kësaj vepre penale është i pandehuri Ilir Doraci, që nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale.

Referuar, analizës juridike si më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim mbi fajësinë e plotë të pandehurit Ilir Doraci, në veprimtarinë e kundërligjshme të lidhur me mbajtjen e lëndës narkotike të sekuestruar, të analizuar më sipër, në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, është kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas cilësimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi plotësisht prej të pandehurit i të gjithë elementëve të figurës së veprës penale, të

parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

Lidhur me akuzën për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge” të parashikuar nga Neni 285/a i Kodit Penal, në ngarkim të të pandehurit Ilir Doraci, Gjykata çmon se veprimet e tij plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t’i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 285/a i K.Penal.

Lidhur me këtë fakt, neni 285/a i K.Penal, përcakton se:

“Neni 285/a i Kodit Penal parashikon se: *“Përshtatja ose lejimi për përshtatjen e lokalit, banesës, mjeteve motorike dhe të çdo mjeti tjetër publik ose privat për grumbullimin e personave me qëllim që ata të konsumojnë lëndë narkotike dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”*”.

Objekt i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj në lidhje me shitjen, dhënien, mbajtjen apo marrjen e substanceve narkotike dhe për të ndaluar përshtatjen e ambienteve për të lejuar përdorimin e tyre, me qëllim mbrojtjen e rendit publik.

Nga ana objektive vepra penale kryhet në formën e përshtatjes apo lejimit të përshtatjes së lokalit, banesave e të tjerë, me qëllim që në këto ambiente të konsumohet lënda narkotike.

Në rastin konkret nga provat e administruara rezultoi e provuar se i pandehuri Ilir Doraci, i cili është personi që administron dhe është përgjegjes i lokalit “WEST” ka përshtatur ambjentet e lokalit të tij për përdorim droge, rezulton se në ambjentet e lokalit të pandehurit i janë sekuestruar 323 gramë lëndë narkotike pa ambalazh njëra dhe 12 gramë pa ambalazh tjetra, e cila sipas aktit të ekspertimit kimik me nr. 1577, datë 12.02.2021 rezulton të jetë cannabis sativa. Pra provohet që në këto ambiente është përdorur lëndë narkotike.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Ilir Doraci, Gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të reflektuar në rëndësinë e marrëdhënieve juridike që prek, mënyrën dhe formën e kryerjes së veprës penale. Gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49 të K.Penal, merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurit në kryerjen e veprës penale (dashje direkte), rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të të pandehurit Ilir Doraci, i cili rezulton të jetë i dënuar më parë.

Kështu, lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, Gjykata, çmon se masa e dënimit sipas pjesës urdhëruese të vendimit do të ishte e përshtatshme, pasi në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar prej saj, dhënia e masës së dënimit me burgim të përcaktuar nga neni 283/1 dhe 285/a i Kodit Penal, çmohet nga Gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të të pandehurit në të ardhme në shoqëri.

Konform ligjit Nr.8328, dt.16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.04.2014, i pandehuri Ilir Doraci, duhet ta vuajë dënimin me burgim në burg të sigurisë së zakonshëm.

Lidhur me kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhimi

dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, për personin nën hetim Ortenc Nazja; si dhe pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, për personin nën hetim Eugen Lazri dhe Erion Pere, Gjykata çmon se kërkesa e organit të prokurorisë është e drejtë pasi në zbatim të parashikimeve të nenit 329/a të K.pr.penale, procedimi i rregjistruar për një krim pushohet me kërkesë të prokurorisë kur konstatohen rastet e parashikuara nga neni 328 pg.1 i Kodit Penal.

Nenin 329/a pg.1 i K.Pr.Penale, parashikon se:

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.”

Neni 328 pg.1 i K.Pr.Penale, parashikon se :

“1. Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) viktimi nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;

ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;

d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;

dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;

e) i pandehuri vdes;

f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.”

Gjykata vlerëson se kërkesa e prokurorit për pushimin e çështjes penale në ngarkim të personit nën hetim Ortenc Nazja për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal është e drejtë për sa kohë që nga hetimet nuk provohet që ai ta ketë kryer veprën penale. Sikundër rezulton nga hetimet shtetasi Ortenc Nazja i pyetur si person nën hetim ka shpjeguar se sapo ishte punësuar prej shtetasit Ilir Doraci dhe ishte në kohë prove. Ai ka shpjeguar se nuk ka lidhje me pjesën e lëndës narkotike që u gjend pas banakut, dhe se nuk është përdorues i lëndëve narkotike përveç ndonjë rasti të hershëm sporadik.

Në bazë të aktit të ekspertimit daktiloskopik nr 11172 date 26.11.2020 është përcaktuar se tek qesja me mbishkrimin “Pads” u gjetën dy gjurmë daktiloskopike në lartësinë 7 cm dhe 3 cm nga fundi i qeses. Këto dy gjurmë janë të vlefshme për identifikim. Në vijim është kryer ekspertimi daktiloskopik krahasues me të dyshuarit e ngjarjes dhe në aktin daktiloskopik nr.1446 datë 09.02.2021 është përcaktuar se këto dy gjurmë janë të krijuara nga gishti i mesit i dorës së djathtë të shtetasit Ilir Doraci.

Sa më sipër nga aktet e administruara gjatë hetimit paraprak nuk arrihet të provohet që personi nën hetim Ortenc Nazja të ketë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 të K.Penal.

Gjithashtu Gjykata çmon se kërkesa e prokurorisë për pushimin e procedimit penal në

ngarkim të personave nën hetim Eugen Lazri dhe Erion Pere për veprën penale të parashikuar nga neni 301 i K.Penal është e drejtë dhe duhet pranuar pasi pas hetimeve të kryera prokurori ka arritur në përfundimin se nuk provohet që personat nën hetim Eugen Lazri dhe Erion Pere të kenë kryer veprën penale të “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës”, të parashikuar nga neni 301 i K.Penal.

Nga aktet rezulton se në datën 19.11.2020, kur nga ana e policisë është ushtruar kontroll në ambjentet e lokalit “West”, gjatë kontrollit në një dhomë të dytë ku sapo punonjësit e policisë u futën dy shtetasit Eugen Lazri dhe Erion Pere kanë filluar të hedhin nga dritarja një lëndë të dyshuar si kokainë. Punonjësit e Policisë i kanë bllokuar dhe kanë sekuestruar një pluhur të bardhë të dyshuar si kokainë në parvazin e dritares ashtu dhe në tavolinën që gjendej në dhomë.

Por nga akti i ekspertimit kimik nr. 1699, date 17.02.2021 është përcaktuar se në pluhurin (2.352 grame) që i është sekuestruar shtetasve Eugen LAZRI dhe Erjon Pere, nuk tregohet për praninë e ndonjë lënde narkotike e psikotrope dhe me mjetet dhe metodat që disponohen nuk mund të percaktohet lloji i pluhurit objekt ekspertimit.

Në rastin konkret Gjykata çmon se nga ana e prokurorit janë kryer veprimet e duhura hetimore dhe ai ka arritur në përfundimin se çështja penale në ngarkim të personave në hetim Ortenc Nazja, Eugen Lazri dhe Erion Pere duhet të pushohet. Gjykata nuk konstaton ndonjë veprim që nuk është kryer nga ana e prokurorit, që nëse do kryhej mund të bënte prokurorin të arrinte në një konkluzion të ndryshëm nga ai që ka arritur. Ai ka patur në dispozicion të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionin e saj.

Në këto kushte, Gjykata çmon se duhet të vendosë pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për personat nën hetim Ortenc Nazja, Eugen Lazri dhe Erion Pere.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato duhet t’i ngarkohen të pandehurit, pasi atij i referohet dënimi në zbatim të nenit 393 të K.Pr.Penale.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe provat shkresore të ndodhura në dosje pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE:

Në vështrim të neneve 379, 384, 390, 405 e 406, 329/b/3 të K.Pr.Penale dhe nenit 283/1 e 285/a të K.Penal, Gjykata:

V E N D O S I:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Doraci, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim.
- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ilir Doraci, për veprën penale “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, të parashikuar nga neni 285/a i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

- Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, në bashkim të dënimeve, e dënon të pandehurin Ilir Doraci, me një dënim të vetëm, prej 7 (shtatë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ilir Doraci, me 5 (pesë) vjet burgim.
- Vuajtja e dënimit fillon nga data e arrestimit të tij në flagrancë në datë 20.11.2020.
- Dënimi të vuhet në një institucion të vuajtjes së dënimit të sigurisë së zakonshme.
- Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238, të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, për personin nën hetim Ortenc Nazja.
- Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238 të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojne zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, për personin nën hetim Eugen Lazri.
- Pushimin e çështjes lidhur me procedimin penal nr. 8238 të vitit 2020, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “Veprime që pengojne zbulimin e të vërtetës”, parashikuar nga neni 301 i Kodit Penal, për personin nën hetim Erion Pere.
- Në bazë të nenit 190/1/b të K.Pr.Penale, lënda narkotike cannabis sativa e sekuestruar, urdhërohet të asgjësohet.
- Në zbatim të nenit 218/1 të K.Pr.Penale, kthimin e celularit i markës samsung, me numer Imei 1 355265056046030/1 dhe IMEI 2 355266056046038/1 me kartë Sim të kompanisë Vodafon me numër +355693124853, të sekuestruar me procesverbalin e sekuestrimit të datës 20.11.2020 shtetasit Ortenc Nazja.
- Në zbatim të nenit 218/1 të K.Pr.Penale, kthimin e telefonit të markës samsung, me numer Imei 355031095650319/01 me pin karte 2208 dhe 9440; pesë preje 2000 mijë lekëshe dhe dy prerje 1000 mijë lekëshe, të sekuestruar me procesverbalin e sekuestrimit të datës 20.11.2020 të pandehurit Ilir Doraci.
- Shpenzimet proceduriale siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 ditëve duke filluar ky afat, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimit.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 05.11.2021.

SEKRETARE

GJYQTAR

ETLEVA AVDIA

SOKOL PASHO

Shpenzimet gjyqësore të Prokurorisë

Total 24500 lekë

Shpenzimet gjyqësore

Njoftime 900 lekë.